

24285

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 24285... Vendimi

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane sot me daten 04 Nëntor 2000 (dymije), une gjyqtarja Dr. Mile
Cop prane Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga kerkuesi Bajram Fejzollari per regjistrimin Person Juridik, ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "TV SOT 7" Sh.p.k.

K O N S T A T O V A

Se kerkuesi Bajram Fejzollari, kerkon regjistrimin Person Juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "TV SOT 7" Sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator Bajram Fejzollari, me kapital themeltar 25.000.000 leke, me seli ne Lagjen Nr.1 ne qytetin e Pogradecit, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me objekt veprimtarie:

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Media vizive nepermjet stacionit TV lokal, spektakle, publicitet dhe çdo operacion tjeter media viziv dhe tregtar i lejueshem nga legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise si dhe importimin e teknikave dhe teknologjive te sherbimit te mediave.

Aktiviteti i shoqerise do te shtrihet kryesisht ne zonen e Prefektures se Korçes.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 dhe te ligjit Nr.7667 dt.28.1.1993 si dhe ligjit Nr.8410 date 30.9.1998,

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin Person Juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "TV SOT 7" Sh.p.k. themeluar nga ortaku i vetem Bajram Fejzollari, me seli ne Lagjen Nr.1 ne qytetin e Pogradecit, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me administrator Bajram Fejzollari, me objekt te veprimtarise: Media vizive nepermjet stacio TV lokal, spektakle, publicitet dhe çdo operacion financiar tregatar te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e shoqerise si dhe importimin e teknikave dhe teknologjive te sherbimit te mediave. Aktiviteti i shoqerise do te shtrihet ne zonen e prefektures se Korçes.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE
Dr. Mile Cop
Cop

- Orientimi 24.285^a TV set 7, 1 & P.e.

- Tëpërholi 25.000.000 lekë

- Tëpërpyetje ambicijave

- She objekt: Keshi vizite repërçy.
Stacioni TV lokal etj.

- She orole Pajisje Fejzollari.

- Keshi Pogradec.

Statisti 6 fletë

Olet the rullim. 3 fletë

Data e ndërrimit 30.08.2000

Data e rep. shënim 04.09.2000

Maner
Gj

AKT THEMELIMI



SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"TV SOT 7" Sh.P.K.

Ne Pogradec sot me daten 12 Gusht 2000, ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Pe Regjistrin Tregtar" dhe ligjit Nr.8410 date 30.09.1998 " Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise", une ortaku i vetem, Bajram Fejzollari, i biri i Feridonit, i vitlindjes 1959, lindur e banues ne lagjen Nr.1, pallati 45, Pogradec, me vullnetin tim te lire e te plote, vendosa te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " **TV SOT 7** " Sh.P.K. Per kete qellim hartohet akti i Themelimit me keto kushte :

Neni 1

Ne kuptimin e ketij akti Themelimi Ortaku i vetem Bajram Fejzollari, eshte themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " **TV SOT 7** " Sh.p.k. me seli ne lagjen Nr.1, Pallati 45 ne qytetin e Pogradecit.

Neni 2

Veprimtaria e Shoqerise, mardheniet e saj me persona te trete, private e shteterore, rregullohet ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare", ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar", ligjit Nr.8410 date 30.09.1998 "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" dhe akte te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ligjeve te mesiperme si dhe te Statutit e ketij Aktit te Themelimit te Shoqerise.

Neni 3


Per detyrimet e e veta shoqeria pergjigjet me pasurine e saja.

Neni 4

Objekti i veprimtarise, emertimi, selia e shoqerise, shtimi i ortakeve dhe ato cka jane percaktuar ne Statut mund te ndryshojne me vendimin e ortakut te vetem dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete : Media vizive nepermjet stacionit TV lokal, spektakle, publicitet dhe cdo operacion tjeter mediaviziv dhe tregetar te lejueshem nga



legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise si dhe importimin e teknikave dhe teknologjiive te mediave.

Neni 6

Shoqeria e ushtron veprimtarine saj ne teritorin e prefektures se Korçes, por ajo mund te dergoje korespondente brenda e jashte Republikes se Shqiperise

Neni 7

Akti i Themelimit do te jete efektiv nga dita e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane. Nga kjo dite shoqeria fiton statusin e Personit Juridik te pavarur. Por transmetimi i stacionit treleviziv do te filloje pasi te merret Liçensa e caktohet frekuenca e transmetimit nga KKRT.

Neni 8

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete mbi dhjete vjet

Neni 9

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 25.000.000 leke. Ai eshte kontribut i ortakut te vetem Bajram Fejzullari. Kapitali i shoqerise mund te rritet sipas deshires se ortakut dhe kushteve ne te cilat do ta ushtroje veprimtarine shoqeria.

Neni 10

Aktet dhe çdo dokument i Shoqerise hartohet nga ortaku i vetem i saj dhe emertimi shoqerise do te ndiqet menjehere nga iniciais Sh.p.k.Shoqeria do te kete vulen e saj.

Neni 11

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte t'i perdori ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj dhe legjislacionin ne fuqi. Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Ortaku i Vetem, fitimi netto mund te perdoret lirisht prej tij.

Neni 12

Shoqeria mund te krijoje disa fonde : Fondin Themeltar, Fondin Rezerve e Fondin e shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te percaktoje edhe fonde te tjera.

Neni 13

Shoqeria do te çeli llogari ne Banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, USD e ne monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ortaku i vetem Bajram Fejzollari.



Neni 14

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 15

Per nevoja te veprimtarise se saj Shoqeria mund te beje punesime te punonjesve duke lidhur kontrata sipas ligjit ne fuqi.

Neni 16

Administrator i shoqerise do te jete ortaku i vetem Bajram Fejzollari, detyrat dhe kompetencat e te cilit percaktohen ne statut.

Neni 17

Ortaku dhe personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionet e burimet e tij, njohurite e pervojën e fituar apo shkëmbyer ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise, si dhe fshehtesine e gjendjes financiare te saj. Ata jane te detyruar te ruajne te fshehte identitetin e shumave e te ardhurave te shoqerise, depozitave te saja dhe veprimtarin e shoqerise te pasqyryar ne bilancin vjetor. Ndaj atyre qe shkelin keto rregulla, Ortaku i Vetem dhe administratori ka te drejte te marri masa ndeshkimore.

ORTRAKU I VETEM THEMELUES

Bajram Fejzollari



STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TV SOT 7” SHPK

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare” dhe Nr. 8410 date 30.09.1998 “Per Radio dhe Televizioni Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise” dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregtar” si dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise “TV SOT 7” shpk, une ortaku i vetem Bajram FEJZOLLARI, i biri i Feridonit, i vitlindjes 1959, lindur dhe banues ne lagjen Nr. 1, Pogradec, hartoj dhe firmos kete statur te shoqerise Tregtare me pergjegjesi te kufizuar “TV SOT 7” shpk me kete permbajtje:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “TV SOT 7” shpk, me kete statut ne perputhje me Aktin e Themelimit te Shoqerise dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi, rregullon poziten juridike te ortakut te vetem, te Administratorit te shoqerise e punonjesve te saj, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizmin, aktivitetin financiar, objektin e veprimtarise te shoqerise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e saj.

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “TV SOT 7” shpk eshte krijuar nga ortaku i vetem Bajram FEJZOLLARI, me mjetet vetjake financiare dhe merr cilesine si person juridik me regjistrimin ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne lagjen Nr.1, Pall. 45, ne qytetin e Pogradecit.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Ky afat mund te zgjatet me vendim te ortakut te vetem themelues ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Media vizive nepermjet stacionit TV lokal, spektakle, publicitet dhe cdo operacion tjeter media viziv dhe tregtar i lejueshem nga legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise si dhe importimin e teknikave dhe teknologjive te sherbimit te mediave.

Neni 7

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane.



Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, por ne transmetim TV vetem ne zonen e prefektures Korce.

Neni 9

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin per mediat dhe telekomunikacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe pergjigjet per detyrimet e veta me pasurine e saj.

III. MJETET E SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 25.000.000 Leke. I gjithe kapitali i perket ortakut te vetem Bajram FEJZOLLARI.

Neni 11

Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem. Ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun qe te kete te drejta pronesie dhe aktivitete jashte kesaj shoqerie.

IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne aktin e themelimit, ne kete statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet materiale e financiare te saj, si dhe mjete e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi te shumes se mjeteve te investuara dhe te shumes se mjeteve te rezervuara.

Neni 14

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

Neni 15

Kapitali themeltar i shoqerise dhe kapitali i mevonshem mund te krijoje nje fond te vecante, i cili mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me statutin e shoqerise dhe ligjet ne fuqi.

Neni 16

Shoqeria do te celi llogari ne banke, do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, ne USD e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakut te vetem.

Neni 17

Shoqeria do te kete keto fonde : Fondi themeltar, fondi rezerve, fondin e shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijojë edhe fonde te tjera. Fondi themeltar i shoqerise formohet nga kapitali themeltar si dhe mjetet teknike e financiare qe do te krijojen gjate aktivitetit te saj.

Neni 18

Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet, per investime te ndryshme ne interes te realizimit te qellimit te shoqerise si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj.

Neni 19

Fondi rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e te ardhurave qe e realizon gjate veprimtarise se saj dhe qe percaktohet me nje vendim te vecante te ortakut te vetem. Fondi rezerve shfrytezohet per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

V: ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 20

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Ortaku i vetem
- Administratori i shoqerise dhe ortakut i vetem **BAJRAM FEJZOLLARI**

Neni 21

Ortaku i vetem ushtron keto funksione: Nxjerr planin dhe programin e veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, per ndryshimin e selise se saj, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh, per ndryshim te administratorit, per caktimin e bordit drejtues. Vendos per rritjen ose paksimin e kapitalit themeltar te shoqerise, miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e formes se organizimit te shoqerise, vendos per programin dhe strukturen dhe kohezgjatjen e tij per transmetimet ne TV. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve. Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per Shoqerite Tregtare", "Per Regjistrin Tregtar", "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise", "Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise", "Per Entin Rregullator te Telekomunikacioneve", "Per sistemin e taksave dhe per te drejta e autorit".



Neni 22

Administratori i shoqerise ka keto detyra:

Organizon e drejton punen dhe veprimtarine se shoqerise. Perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivetin e saj. Pergatit aktet qe jane ne kompetence te ortakut te vetem. Merret me organizmin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, kualifikimin e punonjesve te shoqerise, perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe jane ne kompetence te ortakut te vetem. Pergatit dokumentat per aplikimin per marrjen e licenses dhe caktimin e frekuences transmetuese nga KKRT dhe ndjek gjithë proceduren.

Neni 23

Ne mungese apo pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes, qe caktohet nga ai vete me shkrim.

VI. MENYRA DHE KUSHTT E PERDORIMIT TE FITIMIT

Neni 24

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise i perket ortakut te vetem Bajram FEJZOLLARI, i cili mund ta perdore ate sipas deshires se vet.

VII. MARDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA

Neni 25

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me aktin e themelimit, me kete statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontrata per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

Neni 26

Cdo punonjes ne Shoqeri eshte pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaku, Administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit dhe burimet e tij, njohurive e pervojes se fituar e shkëmbyer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesin e gjendjes financiare, depozitave e te dhena te tjera qe organi drejtues i shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat qe paraqesin sekrete te punes mund te behen te njohura personave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se mardhenieve te punes me shoqerine.

VIII. MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 27

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjete e ortakut te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likuidimit te shoqerise.



Neni 28

Shoqëria mund të shpërndahet me likuidimin e saj. Në rastin e likuidimit të shoqërisë emërtimi i saj do të pasohet nga shenimi "Shoqëria në likuidim të sipër". Në rast shpërndarje të shoqërisë, administratori vendos për mënyrën e likuidimit, ndërsa ortakët i vetëm cakton një ose disa likuidatorë, të cilët bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë detyrimet që ka ndaj personave të tretë.

Neni 29

Shoqëria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet që ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe të ardhurat i mbeten ortakut të vetëm.

Neni 30

Veprimtaria ekonomiko - financiare shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars të vitit pasardhës.

Neni 31

Në rast vdekje të ortakut pasuria i kalon në pronesi trashëgimtareve ligjore në përputhje me dispozitat ligjore për trashëgimime.

Neni 32

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të emërojë avokate dhe ekonomiste si dhe t'u japë të drejta personave të tjerë të veprorë në emer dhe në llogari të tij sipas ligjeve në fuqi.

IX. DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 33

Shoqëria deklarohet e krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit të Tiranës dhe regjistrimin e saj në Zyren e Regjistrimit Tregtar pranë asaj Gjykate. Nga kjo ditë fiton statusin e personit juridik.

Neni 34

Aktivitetin e saj transmetues në stacionin televiziv e fillon pas marrjes së licencës dhe caktimit të frekuencës transmetuese nga KKRT.

Neni 35

Ndryshimet në këtë statut bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë në të cilën nxirret ky statut duke zbatuar dispozitat ligjore përkatëse



Neni 36

Mosmarreshjet ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen nepermjet Gjykates se Rrethit Tirane.

Ortaku i vetem themelues

BAJRAM FEJZOLLARI

Bajram Fejzollari

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 2744 Rep.
Nr.....Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten 30 Gusht 2000 (dymije), u paraqit personalisht para meje noteres Aferdita HAXHIA, me zyre ne Rruga "Zhan D' Ark" pall.6, z. Bajram FEJZOLLARI, me gjeneralitetet e sipershenuara, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova me pasaporten personale Nr. ~~7015784~~ i cili deklaroi se sa siper eshte akti i themelimit dhe statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "TV SOT 7" shpk redaktuar jashte kesaj zyre sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe i firmos ato para meje, ndersa une noterja i vertetoj dhe regjistroj sipas ligjit.



NOTERE
Aferdita HAXHIA

Aferdita Haxhia


V E R T E T I M

Vertetojme se Z.Barjam Fezollari ka llogari rrjedhese ne leke me Nr.323/2712 me shumen 4962300 leke (katermiljonenenteqindegjashtedhj e dymije e treqind leke) dhe llogari rrjedhese ne Valut me Nr.3720/16 ne shumen 315000 DEM (treqindeepesembdhjetmije marka Gjermane),te cilat te konvertuara me kursin e Bankes Kursimeve jane te barabarta me 20317500 leke(njzet milion e treqindeeshtatmbdhjetmije e peseqind leke.) Keto leke jane derdhur ne banken e Kursimeve me mandat Arktimi Nr.037921 me mandat Arketimi Nr.0379197 dhe me urdher xhirimi te brendeshme Nr.0954503.Keto leke te konvertuara gjithesejt jane te barabarta me 25279800(njezetepesemiljoneedyqinde e shtatedhjetenente mije e teteqinde leke). Nga kjo shume 25.000.000(njezetepesemiljon leke)jane derdhur per nder-timin e shoqerise te llojit shpk te emertuar(TV SOT7). Kjo gjendie lekesh do te çbllokohet nga anajone mbase paraqitjes se vendimit te shoqerise.

E leshojme kete vertetim sipse kerkeses se klientit.

Alfred DISHTICA

DREJTOR I DEGES BANKES



K E R K E S E

PER REGJISTRIM PERSON JURIDIK

KERKUESI : BAJRAM FEJZOLLARI, i biri i Fendonit, i vitlindjes 1959, banues ne lagjen Nr.1, Pogradec.

OBJEKTI : Regjistrimi Person Juridik i shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar **"TV SOT 7"** Sh.P.K. Ne baze te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992. Nr.7667 date 28.1.1993 dhe Nr. 8410 date 30.09.1998.

PER PARA

QYKATES SE RREHIT

TIRANE



Une kerkuesi Bajram Fejzollari, me aktin e themelimit te dates 10 Gusht 2000 kam krijuar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **"TV SOT 7"** Sh.P.K. bazuar ne ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992, Nr.7667 date 28.1.1993 dhe Nr.8410 date 30.09.1998, kerkoj regjistrimin Person Juridik te kesaj shoqerite.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete : Media vizive nepermjet stacioni TV lokal, spektakle, publicitet dhe e do operacion tregtar i lejueshem nga legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e shoqerise si dhe importimin e teknikave dhe teknologjive te sherbimit te mediave.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 25.000.000 leke. Selia e shoqerise do te jete ne lagjen Nr.1 ne qytetin e Pogradecit. Kohezgjatja e e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Administrator i shoqerise **"TV SOT 7"** Sh.p.k. eshte ortaku themelues Bajram FEJZOLLARI.

Per sa siper, kerkoj qe pasi te shqyrtoni kerkesen dhe dokumentat, te vendosni sipas objektit te kerkeses.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Bajram FEJZOLLARI

Bajram Fejzollari

W. N. K. i. P. o. u. - o. e. 2000
24.285

4. Capo
30/8/2000
Labibari

PULLE TAKSE

R. SHQIPERISE
PULLE TAKSE

R. SHQIPERISE
PULLE TAKSE

R. SHQIPERISE
PULLE TAKS

R. SHQIPERISE
PULLE TAKS

R. SHQIPERISE